



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPËTINA VITINA

24-11-2014

Prandaj - Prandaj	24-11-2014	vitet
Nr. i Organi Org. broj	numri i krahut	Antiqje Prilog
01-013/1683		Vlera Vrednos



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 13.11.2014, aprovon këtë:

### V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR PARCELAT NR. 3461- 1, NR 3461-51, NR. 3461-161, NR. 2495-0, NR. 2485-0, NR. 2484-11, NR, 2484-12 NË ZK VITI DHE PARCELAT KADASTRALE NR 596-2 DHE 596-3 NË ZK DROBESH

#### Neni 1

Me qëllim të ndërtimit të objekteve me rëndësi të veçantë, të domosdoshme dhe funksionale për realizimin e interesave të përgjithshme - publike për nevojat e Komunës së Vitisë, dhe të nevojave për ushtrimin e kompetencave komunale në përgjithësi, Kuvendi i Komunës së Vitisë SHPALLË interes të përgjithshëm ngastrat kadastrale me numër: 3461- 1, nr 3461-51 nr. 3461-161, nr. 2495-0, nr. 2485-0, nr. 2484-11, nr, 2484-12 në Zonën Kadastrale Viti dhe parcelat kadastrale nr. 596-2 dhe nr 596-3 në Zonën Kadastrale Drobesh.

#### Neni 2

Ngastrat kadastrale të shpallura interes i përgjithshëm nga neni 1 i këtij Vendimi, janë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore të Menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe kanë sipërfaqe të ndryshme.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe e Komunës së Vitisë kurse për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

#### Neni 4

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi 01-013/802 i datës 09.06.2011.

#### Neni 5.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Arkivit

